

Ligji 111/2021 datë 25.11.2021
PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014 “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR₁

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 49 pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e inpleteve bujqësore, ku përfshihen plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, me përjashtim të hormoneve të klasifikuara në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, është 10 për qind. Lista e kategorive të inpleteve bujqësore, sipas këtij neni, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Në nenin 51 shkronja “nj” shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 56, pika 38, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në shkronjën “a” fjalët “50 milionë lekë;” zëvendësohen me fjalët “500 milionë lekë.”;
2. Shkronja “c” shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 148 fjalët “6 për qind” zëvendësohen me fjalët “0 për qind.”.

Neni 5

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për autorizimet e përjashtimit nga TVSH-ja, të lëshuara nga administrata doganore, para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe për këtë kategori autorizimesh nuk lejohet shtyrja e afatit të përmbushjes së tyre.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E
Lindita NIKOLLA

Miratuar në datën 25.11.2021

Botuar ne F.Zyrtare 197/2021

Dale nga shtypi me 21.12.2021